



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Kuvendi i Komunës-

01Nr.470/03-4558/22
Kaçanik, 28.02.2022

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 28 shkurt 2022, pos tjerash;

NJOFTOHET

1. Me Raportin vjetor lidhur me Auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e Auditimit të Brendshëm, për vitin financiar të përfunduar më 31 Dhjetor 2021.
2. Në njoftimin si në pikën 1 të kësaj shkrese janë paraqitur aktivitetet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, konkluzionet dhe rekomandimet për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik, për vitin 2021.
3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese është; “Raporti Vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për vitin 2021/ Lënda 01Nr.470/03-4558/22.

Më këtë shkrese njoftohen: Kryetari i Komunës , Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kema Mursej





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	16.02.22	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
	01		470/03-6JJK	✓

**RAPORTI VJETOR
LIDHUR ME AUDITIMET E BRENDSHME TË KRYERA DHE
AKTIVITETET E AUDITIMIT TE BRENDSHËM PËR VITIN
2021**

Kaçanik, janar 2022

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave.....	3
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
2. HYRJE.....	5
3.QËLLIMI I RAPORIT VJETOR, LIDHUR ME AUDITIMET E BRENDSHME TË KRYERA DHE AKTIVITETE E AUDITIMIT TË BRENDSHËM.....	6
3.1. Aktivitetet planifikuara e NJAB.....	6
3.1.1.Aktivitete e auditimit.....	6
3.1.2.Pergaditja e planit strategjik dhe vjetor.....	6
3.1.3.Aktivitete tjera dhe trajnime.....	6
3.1.4.Pune administrative.....	6
3.2.Aktivitete e realizuara NJAB gjate vitit 2021.....	7
3.2.1.Aktivitete e auditimit.....	7
3.2.2. Planifikim strategjik dhe vjetor.....	8
3.1.3. Aktivitete tjera te NJAB-Takime dhe trajnime te AB.....	9
3.1.4. Pune administrative.....	9
4. KONKLuzionET.....	9
5. REKOMANDIMET.....	10

LISTA E SHKURTESAVE

1. **NJAB** - Njësia e Auditimit të Brendshëm
2. **NJQH/AB** – Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm
3. **SSP** - Subjekti i Sektorit Publik
4. **IAB** - Instituti i Auditimit të Brendshëm
5. **AB** – Auditori Brendshëm
6. **AJ**-Auditori i jashtëm
- 7.**KBFP**-Kontrolli i brendshme i financave publike
- 8.**QRK**-Qeveria e Republikës së Kosovës

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport në përgjithësi prezanton zhvillimet në fushën e auditivit të brendshëm në komunën Kaçanikut për vitin 2021.

Këtu përfshihen aktivitetet e NJAB, konkluzionet dhe rekomandimet për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik .

Auditimi i brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës funksionon në mënyrë të decentralizuar, me palët e interesuara në vijim: Njësitë e Auditimit të Brendshëm, Auditorët e Brendshëm, Komiteti i Auditimit, Menaxhmenti i lartë si dhe NJQH-AB.

Plani vjetor është hartuar në bazë të kohës efektive të punës.

Ndikimi i punës së auditimit të brendshëm gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve dhe mbështetja sistematike e komitetit të auditimit.

Rekomandimet tona kryesore janë:

- Menaxhmenti të përgatit me kohë planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të marra nga auditorët dhe të ndërmer veprime për zbatimin e rekomandimeve nga njësitë përgjegjëse.
- Zbatimi i ligjit të auditivit të brendshëm, funksionalizimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm sipas Rregullores QRK 01/2019, respektivisht fuqizimin e rolit të shërbimeve të auditimit të brendshëm
- Komiteti i auditimit të rishikojë burimet, planet dhe rezultate të NJAB dhe të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit të komunës

2. HYRJE

Raporti është përgatitur në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për kontrollin e brendshme të financave publike, duke paraqitur një analizë mbi të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm.

Raporti vjetor për vitin 2021 është përgatit bazuar në nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (KBFP) dhe nenin 25 paragrafi 3.5 të Ligjit për KBFP. drejtori i NJAB çdo vit kalendarik përgatit dhe dërgon raporte vjetore për të gjitha aktivitet e auditimit të njësisë së auditimit të brendshëm tek menaxhmenti i lartë i SSP (kryetarit), NJQH-AB dhe e njofton komitetin e auditimit të organizatës buxhetore.

Raporti paraqet rezultatet kryesore të aktiviteteve të auditimit të brendshëm në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë vitit 2021 si dhe të aktiviteteve të NJAB , krahasuar me planin vjetor dhe shkallën e realizimit.

3.QËLLIMI I RAPORIT VJETOR, LIDHUR ME AUDITIMET E BRENDSHME TË KRYERA DHE AKTIVITETET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Auditimi i brendshëm është veprimtari e pavarur me siguri objektive dhe këshillëdhënëse, për të shtuar vlerat dhe për të përmirësuar operacionet e organizatës. Ai ndihmon organizatën që të përmbush objektivat e saja, duke sjellë një qasje sistematike, të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efikasitetin e procesit të menaxhimit të rrezikut, kontrolleve dhe qeverisjes”

Qëllimi i këtij raporti është përmbushja e detyrave dhe përgjegjësi të NJAB në bazë të ligjit të KBFP Nr. 06/L-021 dhe përmbushjes së detyrave dhe obligimeve karshi planit vjetor dhe shkallën e realizimit të tij..

3.1.Aktivitetet e planifikuara NJAB

Objektivë e auditimit të brendshëm është vlerësimi i proceseve të veprimit të kontrollit përbrenda organizatës bazuar në vlerësimet e përshtatshmërisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në fushat e audituara.

NJAB gjatë vitit 2021 aktivitetin e vet e ka zhvilluar duke u bazuar në Planin e Punës për vitin 2021 i cili është në harmoni të plotë me strategjinë për funksionimin e auditimit të brendshëm. Planin strategjik për vitet 2021-2032 në bazë të resurseve njerëzore në momentin aktual.

Aktivitetet kryesore të NJAB për vitin 2021 kanë qenë të përqendruara në përmbushjen e planit vjetor dhe atë:

3.1.1.Aktivitete të auditimit:

1. Auditimi “Menaxhimi i personelit për vitin 2020”
2. Auditimi “Menaxhimi i pasurisë komunale për vitin 2020”
3. Auditimi “Menaxhimi i projekteve për vitin 2020-2021”
4. Procesi i menaxhimit të subvencioneve dhe transfereve për vitin 2020 dhe Janar – Qershor 2021”
5. Auditimi “Procedurat e prokurimit për vitin 2021”

3.1.2. Përgatitja e planit strategjik dhe vjetor

3.1.3. Aktivitete tjera, trajnime të ndryshme për arsimim të vazhdueshëm profesional dhe takime të ndryshme me Komitetin e auditimit, NJQH AB, AJ, pjesëmarrje në mbledhjet e kuvendit e kuvendit etj.

3.1.4. Punë administrative-hartimi i raporteve vjetore dhe tremujore, Përcjellja e implementimit të rekomandimeve, përgatitja e mbledhjeve të komitetit të auditimit , përgatitja e materialeve për AJ etj.

3.2. Aktivitete e realizuara te NJAB

3.2.1. Auditimet e kryera gjatë vitit 2021

Plani vjetor është hartuar në bazë të kohës efektive të punës.

Auditimet e kryera gjatë vitit 2021 përfshijnë auditimet e sistemit të pajtueshmërisë dhe rregullsisë, të cilat kryesisht kanë mbuluar me auditimet në këto fusha:

1. Auditimi "Menaxhimi i personelit për vitin 2020"
2. Auditimi "Menaxhimi i pasurisë komunale për vitin 2020"
3. Auditimi "Menaxhimi i projekteve për 2021"
4. Procesi i menaxhimit të subvencioneve dhe transferve për vitin 2020 dhe Janar –Qershor 2021"
5. Auditimi "Procedurat e prokurimit për vitin 2021"

Fushëveprimi i auditimeve të kryera është kryesisht auditime të vitit aktual dhe vitit paraprak. Ditët në dispozicion të planifikuara për aktivitetet e auditimit kanë qenë 133 dite, ndërsa për kryerjen e auditimeve gjatë vitit 2021 janë shpenzuar 133 ditë pune.

Si rezultat i këtyre auditimeve, janë dhënë rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Nga 29 rekomandimet e dhëna : 9 rekomandime janë zbatuar plotësisht, 15 janë zbatuar pjesërisht apo në proces të zbatimit dhe 5 rekomandime janë të pa zbatuara.

Nëse krahasojmë në përqindje (%) nga të gjitha rekomandimet e dhëna gjatë vitit 2021:

- Rekomandimet e zbatuara 31.04%
- Rekomandimet pjesërisht të zbatuara (në procedurë) 51.72% dhe
- Rekomandimet e pa zbatuara 17.24%.

	Emri i auditimit	nr. Rekomandimeve	zbatuara	pjesërisht zbatuara	pa zbatuara
21-01	Menaxhimi i personelit(M)	2	2	0	0
21-02	Menaxhimi i pasurisë	10	0	6	4
21-03	Menaxhimi i projekteve	10	7	3	0
21-04	Procesi i menaxhimit të subvencioneve dhe transferve	2	0	1	1
21-05	Procedurat e prokurimit	5	0	5	0
	Totali:	29	9	15	5
	%	100%	31.04	51.72	17.24

Edhe pse ekzistojnë shumë të gjetura individuale, që shpesh drejt rekomandimeve, ato mund të grupohen në kategoritë e përgjithshme në vijim:

- Dobësi në menaxhimin e pasurive
- Dobësi në menaxhimin e projekteve

-Dobësi në Vlerësimi i mbështetjes financiare të OJQ-ve sipas kriterëve të përcaktuar në rregulloren 04/2017

Për të gjitha këto të gjetura janë dhënë rekomandime adekuatë për përmirësimin. Janë përgatit draft raportet dhe u janë përcjell menaxhmentit të njësisë së audituar. Shumica draft raporteve e janë diskutuar me menaxhmentin, por menaxhmenti nuk ka përgatit plan për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Raportet finale janë përcjell kryetarit, komitetit të auditimit dhe menaxhmentit të njësisë së audituar.

Nga përcjellja e zbatimit të rekomandimeve menaxhmenti ka zbatuar këto rekomandime:

- ✓ Gjatë kësaj periudhe menaxhmentin ka bërë kërkesa të vazhdueshme me MAP për pajisjen me sistemin elektronik për vijueshmërinë në punë dhe ministria ka pajis me komunën me sistemin elektronik për vijueshmërinë në punë që menaxhohet nga zyra e personelit.
- ✓ Këtë vit komuna ka hartuar rregulloren e brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare, që ka qenë rekomandim i auditimit të menaxhimit të automjeteve nga viti 2020.
- ✓ Menaxhmenti para aprovimit të buxhetit ka kompletuar projekt propozimet dhe ka ngritë kapacitete për hartimin e projekteve duke kontraktuar shërbimet për hartimin e projekteve detale për një periudhe dy vjeçare.
- ✓ Vlerësimet e projekteve për vitin 2022-2024 janë në harmoni me kërkesat ligjore sipas Udhëzimeve administrative për kriteret përzgjedhëse të prioritizimit të investimeve kapitale etj.
- ✓ Gjatë planifikimit të projekteve për vitin 2022-2024, menaxhmenti ka përcaktuar kohën e fillimit dhe përfundimit projektit.

Ndërsa përmirësime(pjesshme) në zbatimin e rekomandimeve janë vërejt në:

Regjistrimi i pasurive kapitale, menaxhim të projekteve dhe procesin e subvencioneve dhe trasfereve, ndërsa disa nga rekomandimet e dhëna janë në proces të zbatimit për arsye se kërkohet me tepër kohe për zbatimin e tyre.

Ndërsa rekomandimet e pa zbatuara janë:

Procedura të shkruara për menaxhimin e pasurive dhe ndarjen e detyrave për menaxhimin e regjistrimi i pasurive në programin e-Pasuria, mungesa e një zyrtari për transferim të pasurisë, menaxhimi i kontratave, vlerësimi i projekteve për mbështetje financiare të OJQ-ve etj.

3.2.2. Planifikim strategjik dhe vjetor

Planifikimi është një funksion themelor menaxherial për të gjitha subjektin e sektorit publik.

Planifikimi përfshinë zhvillimin e planit strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm, i cili duhet të jetë në pajtueshmëri me qëllimet dhe planet e organizatës të përcaktuara në bazë të Statutit të Komunës, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji mbi Financat Publike, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, Korniza afatmesme buxhetore 2022-2024, Ligji e Prokurimit, Plani i integritetit për vitin 2019-2021, Rregulloret dhe Udhëzimet e aplikueshme të thesarit si dhe të gjeturat nga auditimet e mëparshme.

Plani strategjik është zhvilluar në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe në pajtim me Ligjin e Kontrollit Brendshëm të Financave Publike, Standardet e Auditimit të Brendshëm, Kodin e etikës së Auditorëve të Brendshëm dhe Metodologjinë për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik të përgatitur nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm.

Plani strategjik 2022-2024 dhe plani vjetor për vitin 2022 i Njesisë së Auditimit të Brendshëm është përgatit nga auditorja e brendshme, në bazë të vlerësimit të rrezikut. Vlerësimi i rrezikut është bazuar në informacionet e grumbulluara përmes metodave si: takimeve dhe intervistave me menaxhmentët e drejtorive komunale, zyrtarë të ndryshëm komunal, pastaj nga analizat e rezultateve të dalura nga auditimet e mëparshme, nga informacionet që ofrojnë qasje publike si dhe nga burime të tjera.

Këto plane janë miratuar nga menaxhmenti i lartë dhe pas miratimit janë dorëzuar në NJQH/AB në afatin ligjor.

Plani vjetor i auditimit është i ndarë nga plani strategjik dhe në të specifikohen auditimet që duhet të kryhen, fushëveprimi i tyre, objektivat, afatin kohor.

Ky aktivitet është realizuar sipas planifikimeve të parashikuara me plan të punës për vitin 2021.

3.2.3. Aktivitete tjera të NJAB –takime dhe trajnime të auditimit të brendshëm

Pos aktiviteteve të detyrave të auditimit kam marrë pjesë në trajnime të organizuara për ngritje të kapaciteteve të auditimit:

- Trajnime në e-Prokurim për auditorë-lansimi i video trajnimeve(online)-USAID, projekti Komuna transparente, efektive dhe llogaridhënëse;
- Punëtori për përmirësimin e praktikave të auditimit në komuna(OSBE);
- Trajnimi për identifikimin e sistemeve të auditueshme dhe vlerësimi i rreziqeve për sistemet e auditueshme –NJQH-AB –IKAP.

Pos trajnimeve gjatë këtij viti janë realizuar edhe aktivitet e planifikuara: Përgatitja e raporteve tremujore për menaxhmentin dhe Komitetin e auditimit, përgatitja e raportit vjetor 2020 dhe raporti gjashtëmujor për vitin 2021 dhe punë tjera administrative, përgatitja e informatave për AJ, përgatitja e informatave për ekspertin e USAID-it për përkrahje në zbatimin e rekomandimeve të AJ dhe përgatitja e informatave për palët tjera të cilat i përkasin fushës së AB.

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të auditimit të brendshëm dhe planit të punës për vitin 2021, kam bërë përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të kryera në vitin 2021 . Gjatë këtij viti nuk është mbajtur asnjë takim i Komitetit të auditimit.

3.2.4. Punë tjera administrative:

Me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi të Drejtorit të NJAB në bazë të nenit 25 , paragrafi 3.5 , nenit 16 dhe nenit 21 paragrafi 1 i ligjit nr. nr. 06/L-021, për Kontrollin e Brendshëm të financave publike, kam përgatitë dhe dorëzuar raportet gjashtëmujore dhe vjetore të NJAB në NJQH, menaxhmentit të lartë-Kryetarit dhe Komitetit të auditimit. Të gjitha raporte janë dorëzuar në afatet ligjore.

4. KONKLuzionet

NJAB gjatë 2021 ka realizuar gjitha aktivitetet e auditimit të planifikuara me plan, por sfida mbetet mungesa e burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave strategjike të NJAB. Zbatimi i rekomandimeve krahasuar me vitin paraprak është me e ulët për 4 %, në vitin 2020 përqindja e zbatimit të rekomandimeve 35%, ndërsa këtë vit është 31%. Ndikimi i punës së auditimit të brendshëm gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve dhe mbështetja sistematike e komitetit të auditimit.

5. REKOMANDIMET

Për të adresuar çështjet e paraqitura në seksionet e mëparshme, ne rekomandojmë veprimet në vijim:

- Menaxhmenti të përgatit me kohë planet e veprimt për zbatimin e rekomandimeve të marra nga auditorët dhe të ndërmerr veprime për zbatimin e rekomandimeve nga njësitë përgjegjëse.
- Zbatimi i ligjit të auditimit të brendshëm, funksionalizimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm sipas Rregullores QRK 01/2019, respektivisht fuqizimin e rolit të shërbimeve të auditimit të brendshëm
- Komiteti i auditimit kryej detyrat dhe përgjegjësitë sipas UA 01/2019, të rishikojë burimet, planet dhe rezultate e NJAB dhe të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit të komunës



Kefsere Koxha

Auditore brendshme